

URDHËR
Nr. 72, datë 31.5.2024

PËR ZËVENDËSIM TË PËRKOHSHËM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të nenit 3, të ligjit nr. 41/2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridik jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të nenit 28, pika “d”, të ligjit 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, si dhe të ligjit nr. 138/2005, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe të urdhrit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 76, datë 18.9.2014, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administrimit të shoqërive huamarrëse”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Znj. Lejdi Qirollari, aktualisht specialist jurist, në shoqëritë huamarrëse në administrim, ngarkohet si zëvendësues i përkohshëm, në pozicionin e administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

2. Zëvendësimi i përkohshëm bëhet për të rregulluar funksionimin normal të institucionit dhe për të siguruar vijimësinë në ushtrimin e detyrave në përgjegjësi të institucionit, deri në plotësimin e pozicionit të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

3. Plotësimi i formularit të deklarimit të pasurisë “Para fillimit të detyrës” në sistemin EACIDS dhe dorëzimi i tij pranë autoritetit përgjegjës të bëhet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës në pozicionin e zëvendësuesit të përkohshëm, të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

4. Dorëzimi i formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike të plotësuar, të bëhet brenda 10 ditëve nga data e emërimit, në pozicionin e zëvendësuesit të përkohshëm, të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

5. Ky zëvendësim nuk shoqërohet me efektet financiare të pozicionit të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete